

ROBERTO BOLAÑO
QENTË ROMANTIKË
Poezi

BOTIMET TOENA

ROBERTO BOLAÑO

QENTË ROMANTIKË

1980-1998

Poezi

Përktheu nga origjinali spanjisht Alban Tufa

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Roberto Bolaño
Titulli në origjinal: Los perros románticos
Botoi në spanjisht: Editorial Acantilado

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817600

© The heirs of Roberto Bolaño, 2006

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

Për Carolina Lopez dhe Lautaro Bolano.

QENTË ROMANTIKË

Atë kohë isha veç njëzet vjeç
dhe i çmendur qeshë.
Kisha humbur një vend
por kisha fituar një ëndërr.
Dhe po të kisha atë ëndërr
për të tjerat s'ma ndiente.
As puna, as lutjet,
as studimi nën rrezet e mëngjeseve
pranë qenve romantikë.
Dhe ëndrra rronte në zbrazëtirën e shpirtit tim.
Një dhomë gjumi prej druri
nën hije,
në një nga mushkëritë e tropikut.
Dhe nganjëherë kthehesha brenda vetes
dhe vizitoja ëndrrën: statujë e përjetshme
në mendime të rrjedhshme,
një krimb i bardhë i spërdredhur
në dashuri.
Një dashuri e shkuar.
Ëndërr brenda ëndrrës.
Dhe makthi më pëshpëriste: do të rritesh.
Do t'i lësh pas imazhet e dhimbjes dhe labirintit e do të harrosh.
Por aso kohe rritja mund të ishte krim.
Jam këtu, pëshpërisja, me qentë romantikë
dhe ja bash këtu do të rri.

AUTOPORTRETI NË NJËZET VJEC

Shkova, i futa marrshin dhe nuk e dija
se ku mund të sosja. Me frikë shkova.
Vrapit ia futa, kaptina më gumëzhinte.
Besoj se qe era e akullt e të vdekurve
s'e di. Mora rrugën, mendova se ishte turp
të ikje kaq beftë, por në të njëjtën kohë
e mbajta vesh atë thirrje të fshehtë dhe bindëse.
O e dëgjon, o s'e dëgjon, dhe unë e dëgjova
e gati ia plasa vajit: zë i tmerrshëm
lindur në ajër dhe në det.
Një mburojë, një shpatë. Kështu,
krejt frikë u lëshova. Faqen e ktheva
buzë faqes së vdekjes.
M'u bë e pamundur të mbyllja sytë e të mos e shihja
atë spektakël të çuditshëm, të avashtë e të çuditshëm.
Dhe pse ngulë në një realitet kaq në ngut,
mijëra djem si unë me fytyra të njoma
ose me mjekër, por latino-amerikanë, të gjithë ne
duke i puqur faqet me vdekjen.

RINGJALLJA

Poezia rrëshqet mbi ëndrra
si një zhytës në liqen.
Poezia, më e guximshme se kushdo,
rrëshqet e bie
plumbçe
në një liqen të pafund si ai i Loch Ness
ose fatkeq e i turbullt si liqeni Balaton.
Këqyreni nga poshtë:
një zhytës
i pafajshëm
veshur më pendët
e vullnetit.
Poezia rrëshqet mbi ëndrra
si një zhytës i vdekur
në sytë e Zotit.

NË SALLËN E LEXIMIT TË FERRIT

Në sallën e leximit të ferrit,
Në klubin e fansave të fantashkencës
Në oborret me brymë
Në dhomat kalimtare të gjumit
Në rrugët e akullta
Kur gjithçka duket më e qartë
Ku çdo çast është më i mirë dhe i parëndësi
Me një cigare në gojë dhe me frikë
Ndonjëherë sytë jeshil
Dhe 26 vjet
Të vërteta.

SONI

Jam në një kafene dhe dikush quhet Soni.
Përtoka është e shtruar me hi. Si zogj,
si zogj të vetëm ia mbërrijnë ca pleq
Archilochus, Anacreon dhe Simonides Miserable.
Refugjatë Mesdheu. Mos më pyesni se çka bëj
këtu, thjesht nuk më kujtohet që kam qenë me një vajzë
e cila qe verdhacuke dhe e pasur. Sidoqoftë, veç mbaj mend që
më kujtohet skuqja,
fjala turp pas fjalës bosh.
Soni! Soni! E shtriva mbrapsht dhe e fërkova
penisin tim në belin e saj. Qeni leh në rrugë.
Poshtë ishte një kinema dhe pasi ia derdha,
mendova “dy kinema” dhe zbrazëtirë.
Archilochus, Anacreon dhe Simonides duke ndukur degët e tyre
të shelgut.
Njeriu nuk kërkon përjetë thashë, e shtriva mbrapsht
dhe e shtiva gjithë gjënë në diçka mes veshëve të qenit... Plasje!
Kemi humbur,
mbetet veç të sëmuresh, thashë dhe Soni
u nda nga grupi Drita e Dritareve të Pista,
e prezantoi si Zotin
dhe autori mbylli sytë.

ERNESTO KARDENAL DHE UNË

Po ecja i djersitur dhe me flokët ngjeshur
në fytyrë
kur pashë Ernesto Kardenalin tek avitej
përballë meje
dhe kur po e përshëndesja i thashë:
Atë, në Mbretërinë e Qiellit,
ç'është komunizmi?
A ka ndonjë vend për homoseksualët?
Po, tha ai.
Dhe për masturbuesit e papenduar?
Dhe për skllëvërit e seksit?
Dhe për shkaktarët e seksit?
Sadomazokistët, laviret, fanatikët e klizmave.
Për ata që nuk durojnë dot më, ata që vërtetë
nuk durojnë dot më?
Dhe Kardenali tha po.
Dhe unë ngrita sytë
e retë m'u bënë si
buzëqeshja rozë e zbehtë e maceve.
Dhe pemët që rrinin mbi kodër
(kodra që duhet të ngjitemi)
tundnin degët e tyre.
Pemët e egra, sikur më thonë:

Një ditë, më shpejt sesa vonë, duhet të vish
në krahët e mi prej gome, në krahët e mi të zhurmshëm,
në krahët e mi të ftohtë. Një ftohtësi jeshile
ka me t'i ngrehë flokët përpjetë.

DITË E PËRGJAKSHME ME SHI

Ah, ditë me shi të përgjakshëm
ç'bën në shpirtin e të harruarit?
Dita e përgjakshme e vullnetit me zor flet:
tej perdes së kallamit, në baltë,
me gishtat e këmbëve përdredhë prej dhimbjes
si kafshë e vogël që dridhet:
ti s'je i vogël, por dridhesh nga kënaqja,
ditë me rrobat e vullnetit veshur,
ngrirë e i shtangur në një moçal që me gjasë nuk është
i kësibotshëm. Këmbëzbathur në mes ëndrrës
që ecën
nga ëndrrat tona deri të nevojat tona
nga inati në dëshirë: perde kallamash,
që na hapet, na ndot, e na përqaf.

KRIMBI

Ju faleminderit për varfërinë tonë, tha dikush i veshur me lecka.

Me këta sy e pashë: tek sillej rrotull në një qytet shtëpish përdhese,

me çimento e tulla diku mes Meksikës dhe Shteteve të Bashkuara.

Ju faleminderit për dhunën tonë, tha ai, dhe pse është sterile si fantazmë, dhe pse nuk na shpie askund.

As këto rrugë nuk të shpien askund.

Me këta sy e pashë: bënte me gjeste drejt sfondit rozë që i bëri ballë të zezës, ah, perëndimeve të diellit në kufi lexuar dhe humbur përjetë.

Perëndimet e diellit që veshën babanë e Lizës në fillim të viteve pesëdhjetë.

Perëndimet e diellit që këqyrën Maria Santiagon tek kalonte, lart e poshtë, dru nga i ftohti, në ulësen e pasme të makinës së një kontrabandisti. Perëndimet e diellit të pafundësisë së bardhë dhe pafundësisë së zezë.

Me këta sy e pashë: ngjante si krimb me kapelë kashte

dhe me vështrimin vrasës

që mori rrugët në qytetet e Meksikës Veriore

sikur të qe i humbur, i lënë mendsh

i lënë nga ëndrra e madhe e të gjithëve

dhe fjalët e tij qenë, *madre mia*, tmerruese.
Më dukej si krimb në një kapelë kashte,
me rroba të bardha
dhe vështrimin vrasës.
Dhe udhëtonte si top
në qytetet e Meksikës Veriore
pa guximin të dorëzohet
pa zgjedhur
të zbresë në D.F.
Me këta sy e pashë:
shkoi e erdhi
mes ambulantëve dhe të dehurve,
frikësuar
me foljen ik nëpër rrugët
e shtëpive prej qerpiçi.
Si një krimb i bardhë dukej
me një Bali¹ mes buzëve
ose një Delicados pa filtër.
Dhe ai udhëtoi nga njëra në tjetrën anë
mes ëndrrave
i tillë si një krimb toke
tek tërhiqte osh dëshpërimin
dhe e hante.

¹ Bali dhe Delicados: Marka cigaresh që shiten në Meksikë (Shën. përkth.)

Një krimb i bardhë në kapelë kashte
nën diellin e Meksikës Veriore
në tokat e ujitura me gjak e fjalët e rreme
të kufirit, dera e Trupit që pa Sam Peckinpah
dera për në Mendjen e lënë, vogëlushi i pastër
kërbaç, dhe krimbi i bardhë i nëmur ishte bash aty
me kapelën e tij prej kashte dhe cigaren e varur
në buzën e poshtme dhe ai kishte të njëjtën pamje si
vrasës i përjetshëm.

E këqyra dhe i thashë se kam tri gunga në kokë
dhe shkenca nuk mundet të bëjë asgjë me mua.

E këqyra dhe i thashë hiqmë para, pinjoll.
Poezia është me e guximshme se çdokush
tokat e ujitura me gjak më rruajnë leshtë e
mendjes që më ka lënë,
mezi lëviz shqisat.

Prej këtyre maktheve do të ruaj veç
këto shtëpi të varfra
këto rrugë me erë
dhe jo vështrimin e tij vrasës.

Ai dukej si krimb i bardhë në kapelën e tij prej kashte
dhe pistoletën e tij nën këmishë
e nuk pushonte së foluri me veten apo me këdo
për një fshat që kishte
të paktën dy a tri mijë vjet

atje në veri, buzë kufirit
me Shtetet e Bashkuara
një vend që ekzistonte ende
si me thënë, dyzet shtëpi,
dy mensa,
një ushqimore,
një qytet vigilentësh dhe vrasësish
si e njëjta gjë,
shtëpi prej qerpiçi dhe oborr me beton
ku sytë nuk u shqitën
nga horizonti
(nga ai horizont ngjyrë mishi
si shpina e një njeriu që po vdes.)
Dhe çfarë prisni të shfaqej atje, e pyeta.
Ndoshta era dhe pluhuri.
Një ëndërr e vockël
por në të cilën ata varën
gjithë kokëfortësinë e tij, gjithë vullnetin e tij.

Dukej si krimb i bardhë në kapelën e tij prej kashte
dhe një Delicados
varur në buzën e poshtme.
Dukej si një kilian njëzetedyvjeçar që qasej në
kafene “Havana”.

Dhe duke parë një vajzë bionde
ulur në fund
me mendtë që e kishin lënë.
Shfaqeshin shëtitjet natën vonë
me Mario Santiagon².
Në mendjen gjetkë.
Në pasqyrat e magjepsura.
Në uraganin e D.F-së.
Gishtat e prerë rilindën
me shpejtësi befasuese.
Gishtat e prerë,
të thyer,
të hapërdarë,
në ajrin e D.F-së.

² Mario Santiago Papasquiaro është emri i artistik i José Alfredo Zendejas Pineda (Mexico City, 25 dhjetor 1953-1998), poet meksikan dhe bashkëthemelues i lëvizjes së poezisë infrarealiste. (Shën. përkth.)

LUPE

Punonte në *la Guerro*, disa rrugë më poshtë *Julians*.

Ishte 17 vjeç dhe kishte humbur një djalë.

Prej kujtimeve ia dha të qarës në dhomën e hotelit “Trebol” dhomë e bollshme, e errët, me banjë dhe bide, vendi perfekt për të jetuar disa vjet. Vendi perfekt për të shkruar një libër me kujtime apokrifë ose një kolazh poezish horror. Lupe

ishte e imët dhe kishte këmbë të gjata me pika si leopard.

Hera e parë që nuk erdha dot:

dhe as doja të vija. Lupe foli për jetën e saj, çka ishte lumturia për të.

Kur kaloi një javë u pamë sërish. E rastisa krah rruspijeve të tjera adoleshente mbështetur në turinjtë e një Kadillaku të vjetër.

Ma merr mendja se ishim të lumtur që u pamë. Prej ahere Lupe nisi të më rrëfente për jetën e saj. Herë me lot në sy, herë dorë për dore me sytë ngulë në tavan.

Djali i saj lindi i sëmurë dhe Lupe i dha besën Virgjëreshës që nëse djali do të shërohej, do të hiqte dorë nga shitja e vetes.

E mbajti llafin për një a dy muaj dhe u kthye sërish.

Sapo i vdiq djali Lupe tha se fajin e kishte vetë, që s’e respektoi Virgjëreshën.

Virgjëresha ia mori engjëllushin si çmim për besën e thyer.

S'dija ç't'i thosha.
Më pëlqenin fëmijët, sigurisht,
por duheshin vite që ta dija
ç'do me thënë të kesh një fëmijë.
Kështu, heshta dhe mendova krejt habi
për heshtjen që kaploi hotelin.
O muret ishin të trashë, o ne ishim të vetmit në të,
Ose të tjerët nuk bëzanin as për të rënkuar.
Ishte shumë e lehtë të kishe Lupen, të ndiheshe burrë,
dhe të ndiheshe shkërdhatë. Ishte e lehtë ta përcillje me ritëm,
me ritmin tënd, dhe ishte e lehtë të dëgjoje refrenin e saj
për filmat e fundit horror që kishte parë
në kinemanë "Bucareli".
Këmbët e saj prej leopardi përthekonin belin tim
tek më zhyste kokën në gjoks duke kërkuar thithat
a rrahjet e zemrës sime.
Këtë dua ta përpij, më tha
një natë.
Kë, Lupe? Zembrën.

ARTILJERËT

Në këtë poezi ushtarët janë bashkë
fytyrat e bardha, duart,
tek ngatërrojnë trupat e tyre ose xhepat e tyre.
Disa mbyllin sytë ose shohin përtokë.
Të tjerë të mendojnë.
Sytë që koha i ka zbardhur. Kthehen
drejt njëri-tjetrit pas pak çastesh.
Përballja veç përforcon
sigurinë e bashkimit të tyre.

FRANCEZJA (*la francesa*)

Një grua e zgjuar

një grua e bukur.

I njihte të gjitha variantet, të gjitha mundësitë.

Lexuese e shprehjeve të Duchamp-it dhe tregimeve të Defoes.

Me një vetëkontroll të lakmueshëm.

Veç rasteve kur ishte në depresion ose e pirë.

Gjë që mund të zgjaste dy-tri ditë.

Një rresht Bordeaux dhe Valium.

Kjo të rrëqethte,

pastaj të rrëfente histori që i kishin ngjarë mes moshës 15 dhe 18 vjeçe.

Një film erotik dhe terror

trupa lakuriq dhe punë të zeza.

Aktore e përpiktë dhe sakaq një çupkë me tipare të habitshme lakmie.

E njoha kur sapo kish mbushur 25 vjeçe

në një periudhë të qetë.

Ma ha mendja se kishte frikë nga plakja dhe vdekja.

Plakja për të ishte 30 vjeçe

beteja tridhjetëvjeçare.

Tridhjetë vjetët e Krishtit kur nisi predikimin.

Moshë si gjithë të tjerat, i thashë, tek darkonim
në dritën e qirinjve
duke kundruar rrjedhën e lumit më poetik të botës
për ne prestigji kish instancë tjetër
në valët e pushtuara nga avashllëku, në gjeste
krejt të avashta
të çakërdisë nervore,
në shtretërit e errët,
në shumëzimin gjeometrik të vitrinave boshe
dhe në vrimën e realitetit.
Absoluti ynë,
Volteri ynë,
filozofia jonë e dhomës së gjumit dhe komosë.
Siç po thosha, një vajzë e zgjuar,
Me virtytin e rrallë që shihte aq larg
(e rrallë për ne, latino-amerikanët.)
Kaq normale në atdheun e saj
aty ku edhe vrasësit kanë libreza banke
dhe ajo s' do ishte më keq.
Një libër banke dhe një foto e Tristan Cabral³
kujtim për të pajetuarit.

³ Tristan Cabral është emri i artistit i shkrimtarit dhe poetit francez Yann Houssin (Shën. përkth.).

Ndërsa ai lumë madhështor tërhiqte zvarrë një diell që po ikte.
Faqeve i zbritën lotët dukshëm kot.
Nuk dua të vdes, pëshpëriti në të ikur.
Në errësirën brisk të dhomës së gjumit
dhe goja m'u qep
vërtet goja m'u qep
veç ta përkëdhelja e ta mbështesja dija, tek ajo lëvizte
lart e poshtë si jeta,
lart e poshtë si poetët e Francës
pa faj, por të dënuar,
derisa ajo zbriti me këmbë në tokë
dhe nga buzët e saj rrodhën
fragmente nga rinia që mbushën dhomën e saj të gjumit
përtokë
skena që lotojnë në shkallët lëvizëse të metrosë
skena duke bërë dashuri me dy djem njëherësh
ndërsa jashtë binte shi
mbi thasë plehrash dhe armësh të braktisura
në thasët e plehrave,
shi që shpërlanë gjithçka
përveç kujtesës dhe arsyës.
Fustane, xhaketa lëkure, çizme italiane, të brendshme që të
çmendin.

Për ta çmendur atë
ata u shfaqën dhe u zhdukën në dhomën tonë fosforeshente
dhe pulsuese
dhe gjurmë të shpejta të aventurave të tjera më pak intime
shkëlqenin syçkat e saj të plagosur si xixëllonja.
Një dashuri që nuk do të zgjaste shumë
por që në fund do të ishte e paharrueshme.
Këtë tha
ulur pranë dritares
fytyra e saj e ngecur në kohë,
buzët e saj: buzët e një statuje.
Një dashuri e paharrueshme
nën shi,
nën atë qiell të mbushur me antena ku jetonin
tavanet me arkë të shekullit të 17-të
me jashtëqitjet e pëllumbave të shekullit të 20-të.
Dhe në mes
të gjithë aftësinë e pashuar për të shkaktuar dhimbje,
të pamposhtur ndër vite,
të pamposhtur përmes dashurive
e paharrueshme.
Kështu tha: po.
Një dashuri e paharrueshme
dhe shkurt,
si një uragan?

Jo, një dashuri e shkurtër si psherëtima e një koke në gijotinë,
koka e një mbreti ose konti breton,
i shkurtër si bukuria
bukuria absolute,
ajo që përmban gjithë madhësinë dhe mjerimin e botës
dhe kjo është e dukshme vetëm për ata që dashurojnë.

MAJMUNI I JASHTËM

A e mban mend *Triumfin e Aleksandrit të Madh* nga Gustav Moreau?

Hijeshija dhe tmerri, çasti i kristaltë kur frymëmarrja krejt ndalet. Por ti nuk ngece nën atë kube, nën hije të zbehta, nën atë kube ndriçuar nga egërsia, rrezet e harmonisë. Nuk t'u ndal fryma.

Rendje si majmun i palodhur mes perëndive, eh, e dije - ose ndoshta jo - se triumfi po shpallte armët e tij në shpellën e Platonit: imazhe hije pa substancë, mëvetësia e zbrazëtirës. Ti dëshiroje

të mbërrije pemën dhe zogun, tepricat e një feste të varfër në ajër të hapur, tokën djerrë ujitur me gjak, vendin e krimit ku ushqeheshin statujat e fotografëve dhe policëve, dhe jetën e ashpër, jashtë në të hapur. Ah, jeta e ashpër në natyrë!

PISËT, VESHUR KEQ

Në rrugën e qenve shpirti ma gjeti
zemrën time. I thyer, por i gjallë,
i pisët, i veshur keq dhe rrafsh me dashni.
Në rrugën e qenve ku askush s'ka dëshirë të shkelë.
Rrugë që e shkelin veç poetët
kur s'kanë ç'bëjnë tjetër,
por unë kisha ende gjithë ato gjëra për të bërë.
Dhe sërish aty isha: duke u dënuar me vdekje
nga thneglat e kuqe, dhe po ashtu
nga thneglat e zeza që bredhin fshatrat zbrazur:
terri u bë piriq
derisa preku yjet.
Një kilian i rritur në Meksikë gjithçka mund të durojë
mendova, por s'qe e vërtetë.
Natës zemra qante. Lumi i qenies thoshin,
buzët nën ethe, që më vonë zbulova se janë të miat
lumi i qenies, lumi i qenies, ekstaza
që paloset këtyre fshatrave të braktisura.
Sumulistët⁴ dhe teologët, parashikuesit
dhe banditët e rrugëve u shfaqën
si realitete ujore në mes të një realiteti metalik.

⁴ Termi i referohet një mësuesi, profesori ose tutori të specializuar në parimet e logjikës, të cilat quhen gjithashtu sumula. Nxënës, student, dishepull i sumulave. (Shën. përkth.)